

**I.Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit, kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik me kohë të plotë të kategorisë Lektor për lëndët në grupin mësimor të Materialeve dhe Teknologjisë së Ndërtimit:**

#### **KRITERE TË PËRGJITHSHME (KUALIFIKUESE)**

1. Kandidati/tja duhet të ketë përfunduar studimet e larta në degën Inxhinieri Ndërtimi dhe të ketë fituar diplomën Master Shkencor ose diplomën e studimeve 5-vjeçare në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (UPT), apo fakultete të huaja analoge.
2. Kandidati/tja duhet të ketë notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta në të dy ciklet apo të ciklit të integruar së paku 80/100.
3. Kandidati duhet të zotërojë gradën shkencore "Doktor", referuar Nenit 36, të Senatit UPT dhe Nenit 59, Ligji Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", fusha e studimit të doktoraturës të jetë pjesë e fushave të studimeve që mbulon Departamenti.
4. Kandidati/tja të ketë përvojë jo më pak se 10-vjeçare në veprimtari didaktike dhe mësimdhënie në lëndët që mbulohen nga departamenti, si dhe të jetë aktivizuar në mësimdhënie dhe veprimtari didaktike në lëndët që mbulohen nga grupi mësimor i "Materialeve dhe Teknologjisë së Ndërtimit".

#### **KRITERE SPECIFIKE (VLERËSUESE)**

1. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve 5-vjeçare ose nota mesatare e përgjithshme e ponderuar e studimeve të larta të dy cikleve apo të ciklit të integruar.
2. Nota mesatare e lëndëve ku parashikohet të aktivizohet kandidati/tja nga grupi mësimor i "Materialeve dhe Teknologjisë së Ndërtimit".
3. Grada shkencore.
4. Eksperiencia në mësimdhënie. Në veçanti eksperiencia e lidhur me gruplëndët që mbulon Departamenti i Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit, të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.
5. Eksperiencia në punë.
6. Publikime, punime shkencore, punime didaktike etj.
7. Kualifikime profesionale, çertifikata, vërtetime etj.
8. Rekomandime.

**II.Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune për Sekretare Mësimore.**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

- a) Të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin “Master i Shkencave”;
- b) Të ketë njohuri të kompjuterit dhe programeve kompjuterike bazë;
- c) Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja, anglishtja do të përbënte avantazh;
- d) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe aftësi për të punuar në grup.

## **DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **24.01.2020** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diploma e studimeve universitare dhe lista e notave të noterizuara.  
(Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
4. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
5. Kopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Certifikatë kualifikimi dhe trajnimesh të ndryshme (në rast se ka);
7. Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar;
8. Raport mjekësor për aftësi në punë;
9. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi.